



BASHKIA
TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.1 E PUNËTORËVE TË QYTETIT
DREJTORIA PLANIFIKIMEVE DHE MENAXHIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **“Leksi Security” shpk me Nipt: L31519018N me Adresë:** Tiranë, Njesia Bashkiake Nr.9, Rruga e Barrikadave, Pallati 36, Shk.1 " me Administrator *Z.Fatmir Hamza.*

1. Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për Propozim”**
2. Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-65897-04-27-2018**
3. Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes (Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara)**
4. Fondi Limit: **4 500 000** (katër milion e pesëqind mijë) **leke pa Tvsh**
5. Burimi i të ardhurave: **Bashkia Tiranë.**
6. Kohëzgjatja e kontratës : Nga data e lidhjes se kontrates deri me 31.12.2018
7. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët
8. Data e zhvillimit të procedurës: **10.05.2018 ora 10:00**

Siç dhe rezultoi nga procesverbali i hapjes në këtë procedurë prokurim u paraqitën katër operatorë ekonomik si më poshtë:

1.Operatori ekonomik **“ARBANA ” sha** me Nipt: **K21310002U** me ofertë ekonomike:

4 098 690.96 (katër million e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë

pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

4 918 429.15 (katër million e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e nëntë pikë pesëmbëdhjetë)lekë me TVSH.

Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi “**ARBANA** ” sha nga ku rezulton se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- Nuk I plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës rezulton se ka gabime aritmetike
 - Në pikën 2.3 të kriterëve të veçante të DST [kapaciteti teknik, pika 3], Autoriteti kontraktor ka kërkuar që Operatori Ekonomik të ketë minimalisht 20 punonjës të siguruar në muaj, 20 punonjës shërbimi roje si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin. Në dokumentat e paraqitura Operatori Ekonomik Arbana sh.a ka paraqitur përkatësisht 18 punonjës për muajin Janar 2018; 19 punonjës për muajin Shkurt 2018; 18 punonjës për muajin Mars 2018. Si rezultat, Operatori Ekonomik Arbana sh.a nuk e përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit.
 - Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në pikën 2.3 të kriterëve të veçante të DST [kapaciteti teknik, pika 5], që Operatori Ekonomik të ketë së paku 4 automjete për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marrë me qera. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik Arbana sh.a, KVO-ja konstatoi se 1 (një) nga 3 (tre) dokumentet e siguracionit të automjeteve (nderkohë që Autoriteti Kontraktor ka kërkuar së paku 4 [katër] automjete), specifiku siguracioni i mjetit të llojit Daihatsu ka skaduar më 01.04.2018.
 - Oferta Ekonomike e Operatorit Arbana Sh.a paraqet gabime si në formulim ashtu edhe në llogaritje, specifiku oferta ekonomike tek pershkimi i shërbimeve është emërtuar si shërbimi i ruajtjes së godines së Ministrise së Arsimit Sportit dhe Rinise, në kundërshtim me objektin e kërkuar nga AK.

2.Operatori ekonomik “LEKSI SECURITY” shpk me Nipt: L31519018N me ofertë totale mujore

Çmimi i ofertës është:

728 981.61 (shtatëqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e një) **lekë pa TVSH**

874 777.93 (tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e tre) **lekë me TVSH.**

Çmimi total i ofertës per gjashtë muaj është:

4 373 889.68 (katër milion e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH**

5 248 667.62 (pesë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë e dy) **lekë me TVSH.**

Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi **“LEKSI SECURITY” shpk** nga ku rezulton se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- I plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës rezulton se nuk ka gabime aritmetike.

3. Operatori ekonomik “Toni Security” shpk me Nipt: **K94010201F** me ofertë ekonomike mujore:

479 430.27 (katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë pikë njëzet e shtatë) **lekë pa TVSH**

575 316.32 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë pikë tridhjetë e dy) **lekë me TVSH.**

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- I plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës rezulton se ka gabime aritmetike

➤ Oferta Ekonomike e paraqitur nga Operatori “Toni Security” është në kundërshtim me Njoftim Nr. 2538 Prot., date 23.02.2018, “Rekomandim mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike”. Specifikisht - Për shërbimin 24 orë, pa ndërprerje (nga e hëna, në të dielë), numri i rojeve për një vendroje duhet të llogaritet me koeficientin e zëvendësimit

1.66 punonjës për turn. Operatori Toni Security nuk e ka përdorur këtë formulë për llogaritje në Ofertën Ekonomike të paraqitur. Si rrjedhojë oferta e paraqitur rezulton anomalisht e ulët. Koeficienti i përdorur në këtë rast është i barabart me 1.

Si rrjedhojë llogaritja e kryer është 3 (vendroje) * 3 (roje) * 1 (koeficienti i

perdorur) * 53,270.03 (çmimi njësi për muaj) = 479,430.27 (oferta për një muaj * 6 muaj) = 2876581,62 lek pa tvsh.

Fakti që Operatori nuk ka përdorur koeficientin e perlllogaritjes të vendosur nga APP dhe KPP e skualifikon.

4.Operatori ekonomik “Eurogjici-Security” shpk me Nipt: **K31929010K** me ofertë ekonomike mujore:

728 981.61 (shtatëqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e një) **lekë pa TVSH**

874 777.93 (tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e tre) **lekë me tvsh.**

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- I plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës rezulton se ka gabime aritmetike

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi konstaton se dy ofertat e paraqitur nga operatorët ekonomik “Leksi Security” shpk dhe “Euro-Gjici Security” vendosi përcaktimin e fituesit nepermjet shortit te zhvilluar ne ambientet e Drejtorise se Pergjithshme Nr. 1 te Punëtorëve te Qytetit më datë 05.06.2018 ora 12.00 .

Nga shorti rezultoi fituese operatori ekonomik “Leksi Security” shpk me oferte ekonomike mujore

Çmimi i ofertës është:

- **728 981.61** (shtatëqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e një) **lekë pa TVSH**
- **874 777.93** (tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e tre) **lekë me TVSH.**

Çmimi total i ofertës per gjashtë muaj është:

- **4 373 889.68** (katër milion e treëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH**
- **5 248 667.62** (pesë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë e dy) **lekë me TVSH.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit , Tiranë për sigurimin dhe nënshkrimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **30 ditëve** nga dita e

marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Klasifikimi u bë me datë **15.06.2018** në sistemin elektronik të APP-së.

Hedhja e shortit më datë 05.06.2018

Ankesa: Nuk ka

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arlinda Binjaku

